



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10446 Prot.

Roskovec, më 02, 12 2022

VENDIM

NR. 85. DATË 01. 12. 2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN TETOR 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 31.10.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Tetor 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 9753/11 Prot.

Roskovec, më 01 . 11 .2022

Procesverbal Nr.11

-I mbajtur sot, date 31.10.2022, ora 12³⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2022.
5. Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec.
6. Për anulimin e pikës 1 të VKB-së Nr.28 datë 28.04.2022 “Për shpërndarjen e fidanëve të ullirit të dhuruar nga Qendra e Transferimit të Teknologjise Bujqësore Vlorë”.
7. Për licencimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në varësi të Bashkisë Roskovec.
8. Për caktimin e një eksperti për projekte për përfitimin e financimeve në fushën e bujqësisë.
9. Për miratimin në parim për vënien në përdorim të tokës në pronësi të Bashkisë Roskovec për projektet në fushën e bujqësisë.
10. Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022.
11. Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në Nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunes Kurjan, Bashkia Roskovec”.
12. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 12⁰⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Goga, B.Kuka, K.Hyska, G.Hoxha, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret që mungojnë : V.Mata, L.Hoxha, B.Çobo, T.Kuka, B.Toska, D.Hoxha.

Prezent nga bashkia: Kryetarja M.Bufi, Nenkryetari M.Goga, Dr.Juridike, Dr.Finances, Dr.Urbanistikes, Sp.Mjedisit dhe lejeve të ndertimit, Sp.Gizit, Dr.Sherbimit Social P/Z/Sherbimit Social, P/Bujqesise.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 13 keshilltare. Kryetari i falenderon anetaret e keshillit për pjesëmarrjen në mbledhjen e sotme dhe fillon me mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Shtator 2022.

Informacioni i pregatitur nga Sekretarja e Keshillit ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, ndarjen dhe zbardhjen e vendimeve. Dy vendimet me karakter normative jane miratuar nga Prefektura.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

4. Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Shtator 2022.

Elmazi-ka shtese ne pagesen e 6% ?Pergjigja eshte jo nuk ka shtesa akoma. Vjollca-pyet per familjen Selimaj, per muajin Gusht 1 anetar, per muajin tjetër me 3 anetar? Sidorela-ne i vendosim si dalin nga sistemi, ato dalin vet automatikisht. Specjalistja e ndihmes ekonomike per Njesine Administrative Kurjan sqaron se familja ne fjale eshte 2 anetar, personi tjetër eshte i ndare me certifikate familjare, Vjollca-pse nje muaj ka ardhur 1 person dhe muajin tjetër 3? Kryetari-kam nje mendim qe te ngrejme nje komision dhe ta verifikojme mbledhjen tjetër kete problem. Vjollca-po kur nje pjestar i familjes nuk eshte kush e firmos dhe mban pergjegjesi? Kerkoj verifikim per ndihmen ekonomike per muajin Gusht dhe Shtator nga komisioni qe do ngrihet. Elmazi-ndihma ekonomike nuk eshte ne kompetencen tone, ndersa per 6% dakort jam te ngrihet komisioni. Ne komision per verifikim do te jete Vjollca, Elmazi dhe Leksi nga keshilli per te verifikuar kerkesat qe ngrihet Vjollca. Anetaret e keshillit jane dakort me propozimin e anetareve te komisionit. Hidhet ne votim projekt-vendimi i dhenies ndihme ekonomike nga fondi i kushtezuar 6% per muajin Shtator 2022. bashke me propozimin e kryetarit per anetaret e komisionit dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

5. Per miratimin e Planit Lokal te Menaxhimit te Mbetjeve per Bashkine Roskovec.

Eksperti dhe specialisti i Gizit Petrit Shyti sqaron planin e menaxhimit te mbetjeve me video-projektor sipas zerave perkates. Per kete projekt-vendim jane zhvilluar edhe degjesat publike. Petriti-kemi llagaritur analizen e kosos se sherbimit, sqaron ne lidhje me percaktimin e objektivave te planit. Shpjegon sherbimin e pastrimit, ku grumbullimi i mbetjeve kryhet 6 dite ne jave ne 4 njesi administrative. Sqaron numrin e kontinierëve dhe kapacitetin e tyre, gjendjen e mjeteve teknologjike. Sherbimi i pastrimit do te kryhet me mjete teknologjike. Sherbimi i grumbullimit te mbetjeve do te behet permes qendres se riciklimit ,mbetjet organike dhe te gjelberta do trajtohen atje dhe do behet pleh organik. Petriti shpjegon ne menyre te permblidhur pikat kryesore te planit, sipas materjalit qe cdo keshilltar ka. Hidhet ne votim Plani Lokal i Menaxhimit te Mbetjeve per Bashkine Roskovec dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

6. Për anulimin e pikës 1 të VKB-së Nr.28 datë 28.04.2022 “Për shpërndarjen e fidanëve të ullirit të dhuruar nga Qendra e Transferimit të Teknologjise Bujqësore Vlorë”.

Viktor Kola P/Bujqesise sqaron projekt-vendimin e anulimit te pikes 1 te VKB-se Nr.28 date 28.04.2022. Bima e ullirit nuk ben pjese ne fondin pyjor. Nuk lejohet qe ne ate siperfaqe te mblidhen ullinj. Kjo pjese do te anulohet tani, ne do e sjellim ne mbledhjen tjetër se ku do ti shperndajme keto fidan. Ju mund te jepni sugjerime ku mendoni se mund ti mbjellim. Genci-nuk mund ti nderrojme dot ullinjte me peme tjetër? Kryetarja-jo nuk lejohet te nderrohen. Viktori sqaron se po e anullojme kete pike, pasi bima e ullirit nuk ben pjese ne llojet qe mund te mbillen ne fondin pyjor. Nuk ka diskutime. Hidhet ne votim projekti i anulimit te pikes 1 te VKB Nr.28 date 28.04.2022 dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

7. Për licencimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në varësi të Bashkisë Roskovec.

Dr.e Sherbimit Social E.Shehu sqaron projekt-vendimin për licencimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në varësi të bashkisë “Qendra e kujdesit ditor PAK” dhe “Kafe me Gjyshin”.Leximi-deeritani këto si kanë funksionuar,në mënyrë të jashtëligjshme?Eni-jo,në kemi kontratë me UNDP,e cila e ka miratuar pa regjistrimin në QKL.Nuk ka me diskutime.Hidhet në votim licencimi i shërbimit të kujdesit shoqëror në varësi të bashkisë “Qendra e kujdesit ditor PAK” dhe “Kafe me Gjyshin” sipas materialit dhe miratohet unanimitet me 13 vota pro.

8. Për caktimin e një eksperti për projekte për përfitimin e financimeve në fushën e bujqësisë.

Dr.Juridike sqaron projektin.Për të aplikuar në projektet në fushën e bujqësisë është e nevojshme caktimi i një eksperti në fushën e bujqësisë.Rrapi-pse vetëm këto projekte,se me i rëndësishëm për bujqësinë është një laborator.Po kthehen shumë kamione me produkte bujqësore nga pesticidet.Nëse bëjmë një laborator na zgjidhet problemi.Maksi-këto projekte kanë qenë me destinacion të caktuar për këto 2 projekte.Genci-këto fonde kush do i përfitojë?Vjollca-do i përfitojë bashkia.Bashkia i ka derguar Ministrisë së Bujqësisë 2 projekt-propozime bazuar në nevojat që kemi si :pikë për grumbullimin e vajit të ullirit ,dhe linjë të perpunimit të produkteve bujqësore.Për këtë arsye kërkohet angazhimi i një eksperti të fushës për hartimin dhe projektimin e projekteve në fushën e bujqësisë.Hidhet në votim projekti sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitet me 13 vota pro.

9. Për miratimin në parim për vënien në përdorim të tokës në pronësi të Bashkisë Roskovec për projektet në fushën e bujqësisë.

Dr.Urbanistikes sqaron projektin.Sqaron se kemi aplikuar për projektin “Linjë perpunimi të perimeve të fushës,perdorimi i energjisë solare”.Do vendoset në përdorim pasuria Nr.406/1-F e cila është në pronësi të bashkisë tone.Maksi-në do aplikojmë për 2 projekte siç është perpunimi i produkteve bujqësore dhe grumbullimi i vajit të ullirit.Kemi plot fermerë sot që e marrin vajin e ullirit dhe nuk kanë ku ta shesin.Jemi në parim,këto toka që kemi të shfrytëzojmë për të shërbyer fermerëve.Elmazi-këto toka që kërkoni të vini në përdorim,a kanë pronar këto toka?është e lirë?Eneida-është tokë në pronësi të bashkisë dhe është tokë e lirë.Për token e Vloshit jemi në procedurë regjistrimi.Eneida sqaron se toka e cila është në pronësi të bashkisë do të vihet në përdorim për projekte në fushën e bujqësisë “Linjë perpunimi të perimeve të fushës,perdorimi i energjisë solare”.Venja në përdorim e pasurisë do të bëhet pas miratimit të projekt-propozimit nga Ministria.Hidhet në votim projekti sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitet me 13 vota pro.

10.Për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022.

Dr.Finances S.Çepele sqaron projektin.2 janë arsyet pse e kërkojmë këtë projekt,sepse catia ka filluar të fusë ujë,dhe rrezikohet edhe laboratori i kësaj shkolle.Maksi-ajo shkolle ka pasur dhe ka problematika në tarrace,duke shfrytëzuar fondin i bëjmë mirë shkolles dhe komunitetit.Leksi-është një gjë e mirë se kjo është kërkuar edhe me parë,jo vetëm për laboratorin por edhe për catinë se janë femijet që mesojnë aty.Selmani-ky investim është emergjent pasi po afrohet dimri,do nisnin reshjet dhe çarja e tarracës con në depertimin e ujit në klasat e katit të dytë.Rrezikohet edhe Laboratori i Kodimit i cili do instalohet në katin e dytë.Hidhet në votim projekti për miratim fondesh dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2022 sipas materialit dhe miratohet unanimitet me 13 vota pro.

11. Për përditësim në listën e inventarit, miratuar me VKM-në Nr.108 datë 17.02.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunes Kurjan, Bashkia Roskovec”.

Dr. Urbanistikës sqaron projektin. Kryetari-ato depot aty kanë qene shtetërore, e keni zgjidhur kete si problem? Maksi-nga Ministria e Bujqësisë do kaloje direkt tek ne. Eneida sqaron përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin e Njesisë Administrative Kurjan dhe konkretisht këtij inventari do të shtohet prona me nr.213 zk 3805 fshati Vlosh, Njesia Administrative ve Kurjan. Hidhet në votim përditësimi i listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin e Njesisë Administrative Kurjan sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

12. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Aleksander-pyet për bazen materiale në shkollë, nuk kanë ardhur akoma. Vjollca-pyet për emrat e nxënësve të Mbersit. Selmani-do të fusim me emrat e tjere që kemi kaluar. Maksi-Aleksandrit për bazen material, thote se do të shpërndajme. Nuk ka më diskutime. Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska